



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:150920

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05577152

PA1.nr.1285/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve Q.E nga, Komuna e Pejës për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së dhe E.E nga, Komuna e Pejës për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit Q.E, av. Y.G K dhe ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit E.E av.H.M të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.469/23 të dt.12.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit Q.E, av. Y.G.K dhe ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.E av. H.M, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.469/23 të dt.12.07.2023 lidhur me vendimin mbi dënimin, ashtu që të pandehurit Q.E, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së i vërtetohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, ndërsa për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së për te cilën është shpallur fajtor i shqiptohet dënim me kusht, ashtu që i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashhtë) muajve e i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri brenda periudhës se verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale si dhe të pandehurit E.E për veprën

penale Mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së i vërtetohet dënimi me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, ndërsa për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2, të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor i shqiptohet dënim me kusht, ashtu që i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve e i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri brenda periudhës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale.

II. Ne pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin, P.nr.469/23 të dt.12.07.2023, të akuzuarin Q.E e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale si në pikën I të dispozitivit të aktgjyimit dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën detyrohet t'a paguaj i pandehuri në afat prej 3 muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit, e në rast se i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund t'a paguaj dënimin me gjobë gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku 1 (një) ditë e kaluar në burg do të llogaritet me 20 (njëzetë) euro të gjobës dhe për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të aktgjyimit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit. Të pandehurit E.E e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale si në pikën I të dispozitivit të aktgjyimit dhe i ka shqiptuar dënime gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro të cilën detyrohet t'a paguaj i pandehuri në afat prej 3 muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit, e në rast se i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund t'a paguaj dënimin me gjobë gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku 1 (një) ditë e kaluar në burg do të llogaritet me 20 (njëzetë) euro të gjobës. Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të aktgjyimit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj , i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit.

Obligohen të dënuarit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësorë të paguajnë shumën prej 20 (njëzetë) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën nga 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Konfiskohet një pushkë automatike prodhim i panjohur , një karikator i së njëjtës armë, 3 dylbi dhe 30 fishekë kalibër 7.62 mm. Kërkesë pasurore nuk pati nga i dëmtuari.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësja e të akuzuarit Q.E, av. Y.G.K, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me lartësinë e dënimit, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në kuptim të zëvendësimit të dënimit me burgim prej 6 muajsh në dënim me gjobë. Të zbritet dënimi me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro . të bëhet unifikimi i dënimit, të zbritet dënimi i shqiptuar apo dënim të kushtëzuar, sepse edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ligjor i dënimit.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.E, av. H.M për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj këtë ankesë, ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje apo ta ndryshoj aktgjykimin ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënimin më të butë.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1319/23 të datës 13.10.2023, ka propozuar që të refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtëseve të të akuzuarve, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantoi i akuzuari, Q.E ,i akuzuari , E.E dhe i dëmtuari E.E i cili deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike duke shtuar se me të njëjtët janë pajtuar dhe kanë rregulluar raportet, nuk kanë më probleme. I akuzuari, Q.E deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar dhe propozimit si në ankesë të parashtruar duke shtuar se me të dëmtuarin janë pajtuar dhe i kanë rregulluar raportet pasi që me të njëjtin janë edhe familjar dhe se gjithçka që ka ndodhur ishte në afekt sepse më parë nuk kanë pasur probleme të tilla. I akuzuari, E.E deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar dhe propozimit si në ankesë të parashtruar brenda duke shtuar se i vjen keq për situatën që ka ndodhur, i kërkon falje palës së dëmtuar dhe gjykatës pasi që thotë jurist është edhe vet duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesat janë pjesërisht të bazuara.

Mbrojtësja e të akuzuarit Q.E, av. Y.G.K e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal , me pretendimet se gjykata e shkallës së një dënim i tillë është shumë i lartë , për faktin se i pandehuri Q.E e ka pranuar fajësinë në seancën fillestare , ka kërkuar falje në seancë, me të dëmtuarin janë pajtuar në bazë të traditave dhe zakoneve, ka shprehur keqardhje, më parë nuk ka qenë i dënuar dhe është mbajtës i vetëm i familjes, ka gjendje tejet të rëndë ekonomike pasi që nuk ka një punë të rregullte, por jeton vetëm nga pensioni të cilin e gëzon si veteran i luftës së fundit në Kosovë. Po ashtu , konsideron se gjykata e shkallës së parë fare nuk ka arsyetuar rrethanat të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit dhe nuk ka aplikuar drejtë dispozitat për matjen e dënimit e as nuk ka bërë unifikim të dënimit, përkundër kësaj, gjykata nuk ia ka dhënë as mundësin e zëvendësimit të dënimit me burgim prej 6 muajsh në dënim me gjobë. Propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me lartësinë e dënimit, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në kuptim të zëvendësimit të dënimit me burgim prej 6 muajsh në dënim me gjobë. Të zbritet dënimi me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të bëhet unifikimi i dënimit, të zbritet dënimi i shqiptuar apo dënim të kushtëzuar, sepse edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ligjor i dënimit.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.E, av. H.M e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se dënimi i shqiptuar nuk krijon efekte preventive ashtu edhe represive në raport me veprën , masën dhe lartësinë e dënimit, ngase nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat përkatëse të qëllimit të dënimit, preventivës dhe represives të KPPK-së. Konsideron se dënimi i shqiptuar është i rënd dhe nuk është në proporcion me veprimet inkriminuese të akuzuarit. Tutje shton se i pandehuri është dorëzuar vullnetarisht tek autoritetet dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për të fshehur veprën penale. Madje ai i ka njoftuar vetë autoritetet duke i ndihmuar ata në ndriçimin e rastit në fjalë, nuk ka asnjë dosje tjetër penale dhe nuk është recidivist. I pandehuri është i ri, një njeri familjar dhe dënimi i shqiptuar është tejte i lartë duke marr parasysh se i dënuari nuk ka të ardhura personale sepse është i papunë. Propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj këtë ankesë, ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje apo ta ndryshoj aktgjykimin ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënimin më të butë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtëseve të të akuzuarve, që të akuzuarve t’iu shqiptohet dënim më kusht ose dënim më i butë, janë pjesërisht të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurit gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e shfaqur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla si dhe keqardhjen dhe kërkim faljen që i kishin bërë palës së dëmtuar , ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë për ta kryer veprën penale.

Një konstatim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë e pranon edhe kjo gjykatë mirëpo kolegji vlerësoi se marrë parasysh pretendimet ankimore të akuzuarve si dhe deklaratës së të dëmtuarit të dhënë në seancë, kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë vlerësimin e duhur rrethanave lehtësuese që shkojnë në favor të akuzuarve, gjithashtu kolegji mori parasysh si rrethanë dhe faktin se tani më të akuzuarit me të dëmtuarin nuk kanë probleme, pra i kanë raportet e mira në mes vete, të njëjtit janë familjarë dhe asnjë herë më parë nuk kanë pasur probleme në mes vete, andaj të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh edhe pranimin e fajësisë së të akuzuarve, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurve, premtimin se nuk do të përsërisë veprime të tilla, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga kjo gjykatë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se kjo do t’i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1285/23, më datë 27.02.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Mehmet Ndrecaj

Zyhdi Haziri
